



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 808 Prot.

Tiranë, më datë 17.08.2020

VENDIM

Nr. 263, datë 17.08.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48 dhe neni 134, pika 1, dhe V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë në Këshillin Teknik të projektit dhe raportit të vëzhgimit arkeologjik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 17.08.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit zhvillimor “Kompleks banimi me 2 dhe 3 kate me 1 nëntokë, me pishina dhe mur rrethues”, vendndodhja në Rr. “Mustafa Xhabrahimi, pranë Liqenit të Thatë, Bashkia Tiranë, me zhvillues shoqërinë “Orion” sh.p.k dhe raporti i vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor i realizuar nga person i licencuar në arkeologji z. Ols Lafe;
 2. Subjekti aplikues duhet të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
 3. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin e “Kompleks banimi me 2 dhe 3 kate me 1 nëntokë, me pishina dhe mur rrethues”, vendndodhja në Rr. “Mustafa Xhabrahimi, pranë Liqenit të Thatë” si dhe Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt.
 4. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 144-147;
 5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
 6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

KRYETAR

Elva MARGARITI

